



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
13.9.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Berat Lahu (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti, (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Petrit Reçica (LVV) dhe Arbër Limani (LVV).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Jehona Lushaku, nënkryetare, Alban Zogaj, nënkryetar, Valbona Ajeti, drejtore e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Faqe 1 nga 10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Doruntina Maloku, drejtore, propozoi që pika e tretë: "Propozim- vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "4 A", SHPK, dhe pika e katërt: "Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të Ruzhdi (Maliq) Ejupit", të hiqen nga rendi i ditës, për shkak të një ankese që ka ndodhur në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor lidhur me kushtet ndërtimore.

Florent Maliqi, drejtor, tha se ne kemi kërkuar që të tërhiqet kjo pikë, për shkak se i kemi disa dyshime në Drejtorië e Urbanizmit dhe e kemi formuar një komision për rishikimin e ligjshmërisë së çështjes.

Leutrim Retkoceri, kërkoj që pika e tretë, e katërt dhe e pestë, që kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, të tërhiqen nga rendi i ditës.

Gëzim Sveçla, propozoi që pika e tretë, e katërt dhe e pesëtë, të largohen nga rendi i ditës. Po ashtu, propozoi që në rend të ditës të hyjnë pikat: "Propozim-vendimi për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" dhe "Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".

Leutrim Retkoceri propozoi që në rend të ditës të futen pikat: "Propozim-vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Prishtinës" dhe "Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban".

Arbër Sadiku, drejtor, propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika e gjashtë: "Propozim-vendimi për ndryshimin e ri parcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale të banimit individual të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" dhe ndërrimin e destinimit të bllokut 1-1, Q-2, 1-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi i z. Sveçla, që Propozim-vendimi për shkarkimin e aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", të futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi i z. Sveçla, që Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", të futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për dhe 2 abstenime, u miratua propozimi i z. Sveçla, që Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", të futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Retkoceri, që Propozim-vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023, të futet në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshimet dhe propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se, më 26 vota për dhe 6 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve";
3. Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve";
4. Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban";
5. Propozim-vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023;
6. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01-020.04-215695/23, dt. 3.11.2023;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve NPL-së "Kuzhina Qendrore", SHA në Prishtinë;
8. Raporti i punës së NPL "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë;
9. Raporti i punës së NPL "Sport Marketing" për vitin 2023-2024, SHA, Prishtinë;
10. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 2 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe të gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për shkarkimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".

Gëzim Sveçla tha se, arsyeja pse po kërkojmë shkarkimin e aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve", është sepse të njëjtit nuk kanë qenë në krye të detyrës, nuk kanë arritur t'i përfaqësojnë interesat e Kuvendit, i cili i ka deleguar në këto pozita, dhe ekzistojnë dyshime të bazuara për keqpërdorim të parasë publike nga ana e bordit dhe të njëjtit nuk kanë marrë asnjë masë, asnjë veprim që do t'i sanksiononte këto veprime të jashtëligjshme.

Amir Simnica tha se ne si aksionarë jemi munduar që të jemi të përpiktë dhe me politikat e brendshme është marrë vetëm bordi i ndërmarrjes, kështu që për çdo gjë që ka dyshime rreth ligjshmërisë së Komisionit të aksionarëve komunal, ne jemi të gatshëm që t'i përgjigjemi Prokurorisë.

Lidhur me vërejtjet e paraqitura nga z. Gëzim Sveçla, sqarime të nevojshme dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 9 abstenime, u miratua Vendimi për shkarkimin e Donjeta Dragushës dhe Amir Simnicës, anëtarë të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".

Pika e tretë

Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".

Arianit Beqiri, për anëtarë të Komisionit të aksionarëve në NPL "Stacioni i Autobusëve", propozoi **Nora Kelmendin** dhe **Gëzim Sveçlën**.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 9 abstenime, u miratua Vendimi për emërimin e Nora Kelmendit dhe Gëzim Sveçles anëtarë të Komisionit të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve".

Pika e katërt

Propozim-vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve në NPL "Trafiku Urban".

Leutrim Retkoceri tha se, sa i përket propozimit për emërimin dhe formimin e komisionit të aksionarëve në një ndërmarrje të rëndësishme siç është "Trafiku Urban", vjen pas situatës kur ndërmarrja gjendet pa komisionin e aksionarëve, për shkak të shkëputjes nga koalicioni i PDK-së në Prishtinë me qeverisjen dhe ish-asamblistëve aksionarë, për t'u hapur rrugë krijimit të një shumice të re, në mënyrë që të funksionojë kjo ndërmarrje.

Muhamet Selmani, për anëtar të Komisionit të aksionarëve në NPL "Trafiku Urban", propozoi Muhamet Gubetin.

Granit Geci, për anëtar të Komisionit të aksionarëve në NPL "Trafiku Urban", propozoi Triumf Sadikajn.

Lidhur me vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 9 kundër, u miratua Vendimi për emërimin e Muhamet Gubetit dhe Triumf Sadikajt, anëtarë të rinjë të Komisionit të aksionarëve në NPL "Trafiku Urban".

Pika e pestë

Propozim-vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023.

Leutrim Retkoceri tha se, ne kemi kërkuar që të shfuqizohet paragrafi 3 i nenit 16 të Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave, me arsyen se ky paragraf ka kaluar nevojën emergjente për angazhimin e operatorëve të tjerë, ndërsa mos ndryshimi i këtij paragrafi do të mund të sillte edhe keqpërdorime të tjera në të ardhmen nga individë të caktuar në dëm të operatorit publik, prandaj propozojmë që të votohet për shfuqizimin e këtij paragrafi.

Gëzim Sveçla tha se ne si GP i LVV-së e përkrahim për miratim këtë propozim-vendim për shfuqizimin e paragrafit 3, të nenit 16 të Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Endrit Zabërgja theksoi se tendencat e tilla për shfuqizimin e këtij paragrafi më shumë po më duket tendenca për bllokimin edhe për krijimin e kushteve sa më të vështira për ta pastruar Prishtinën, se sa tendencë për me e lehtësuar dhe besoj se ne si asamblistë kemi përgjegjësi, andaj qytetarët e Prishtinës duhet ditur që fajtorët i kanë në asamble e jo në ekzekutiv.

Feim Osmani u shpreh se kur e kemi diskutur këtë rregullore kemi qenë kundër, pikërisht për shkak të shpenzimeve të dyfishta dhe problemet që do t'i shfaqen ndërmarrjes "Pastrimi" me operatorë të rinjë, dhe kjo ka ndodhur, kështu që unë mendoj se duhet të

shfuqizohet ky paragraf, që mos t'iu jepet mundësia operatorëve privatë dhe të shpenzohen miliona euro dhe prapë Prishtina të jetë e papastër.

Faton Zeka tha se interesi ynë dhe i ekzekutivit është, se ne këtu të gjithë duhet gjetur zgjidhje se si me i ndihmua ndërmarrjes "Pastrimi", por duke ia mbivendos një menaxhment, i cili punon për pastrimin dhe grupe të caktuara të interesit.

Arianit Beqiri tha se çështja kryesore është që Kryeqyteti ynë të jetë i pastër, por prapë se prapë lagjet tona kundërmojnë nga mbeturinat edhe nëse i kemi pagua kompanitë private për me i bartur mbeturinat, për shkak se pastrimi nuk ka mundësi që të bëjë bartjen e tyre në të gjitha hapësirat e kryeqytetit dhe të rrethinës.

Dasmor Durmishi theksoi se Komuna e Prishtinës ka më se njëzet vjet që i mban pesë komuna të tjera me paratë e Komunës së Prishtinës, paguhen punëtorët e komunave tjera që udhëhiqen nga kryetarët e subjektit politik LVV, kështu që falimentimin e "Pastrimit" është duke e bërë Vetëvendosja me kryetarë të atyre komunave, bashkë me bordin që e kanë aty.

Triera Kasumi - Berisha tha se, për kompaninë "Pastrimi" nga ana e Komunës, asnjëherë nuk ka qenë një planë konkret se si me e nxjerrë prej falimentimit, andaj kërkoj të dijë se cilët janë hapat që janë ndërmarrë për ta ndryshuar gjendjen në këtë ndërmarrje.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerime e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Bekim Brestovci, drejtor, dhe Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për shfuqizimin e paragrafit 3 të nenit 16 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, 01-030/01-227581/23, dt. 1.12.2023.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. 01-020.04-215695/23, dt. 3.11.2023.

Kryesuesi tha se në mungesë të iniciuesit të kësaj pike, z. Bahri Gashi, këtë propozimvendim e tërheqim nga rendi i ditës.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve NPL-së "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

Lidhur me Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve të NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Jehona Lushaku, nënkryetare.

Gëzim Sveçla tha se, nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme edhe për blerjen e këtyre kuzhinave, e jo me kërkuar një subvencion, kur ne tani jemi veç se në zhvillim të këtij procesi të mësimit tërëditorë, kështu që tash nëse pajisjet janë blerë, pse duhet subvencioni. Çka nëse nuk e votojmë subvencionin, çka ndodh, a rrezikohet procesi tërëditorë me këtë?

Faqe6nga10

Ka ankesa në mënyrën se si ndërmarrja "Kuzhina Qendrore" po i realizon këto blerje, ose a duhet prapë që t'i realizojë edhe për tri objekte të tjera të cilat janë ndërtim anekset, kuzhinat modulare me atë kontratën e negociuar. Mendoj se nuk do të ishte në rregull që për hirë të një gjëje më të madhe t'i mbydhim sytë për disa parregullësi që po ndodhin përgjatë procesit.

Jeta Rafuna tha se duke pasurë parasyshë se me kapacitetet ekzistuese, ndërmarrja publike "Kuzhina Qendrore" nuk ka pasur mundësi që të ofrojë kushte të kërkuara mjaftushëm për ushqimin e këtyre fëmijëve, e ka pasur të nevojshme të fillojë me procedura të blerjes së paisjeve të reja dhe të automjetve shtesë, andaj dhe ne duhet t'i ndihmojmë me mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth furnizimit me ushqim të fëmijëve. Këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

Muhamet Selmani theksoi se është e padiskutueshme që është shumë e nevojshme përkrahja e këtij subvencionimi, por brenga është se a do të vijnë pajisjet me kohë nëpër shkollat, në të cilat kanë nisur një projekt i tillë. Lidhur me këtë kërkoj të dijë arsyen se pse nuk ka ardh më herët si kërkesë, në çoftëse kemi bërë një plan për këto furnizime. Si grup parlamentar e mbështesim pa rezervë këtë propozim-vendim, mirëpo dyshojë dhe kamë rezervë në realizimin e këtij projekti.

Feim Osmani tha se për të pasur suks një projekt i tillë për mësimin tërëditor, duhet të përfshihen të gjitha shkollat fillore dhe jo vetëm pesë shkolla, kështu që Komuna duhet ta ketë parasysh këtë çështje e të krijojë kushte, e në veçanti të krijojë kushte që shkolla fillore në fshatin Besi të përfundojë sa më parë, sepse nëse në vitin e ardhshëm do të duhej të përfshihej edhe ajo shkollë për zhvillimin e mësimin tërë ditor, reforma sdo të jetë e plotë asnjëherë nëse nuk përfshihen të gjitha shkollat e Prishtinës.

Arianit Beqiri tha se ne si Grup i Lëvizjes Vetëvendosje, kemi treguar disa herë që jemi të interesuar për bashkëpunim, sidomosë në pikat në të cilat e shohim që kanë interes dhe prekin sidomos fëmijët dhe secilin qytetar, edhe është e rrugës për me ndihmuar këtë proces.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket subvencionimit të kësaj ndërmarrjeje, mendoj se do të ishte shumë me e nevojshme që nga Kuzhina Qendrore të jetë kryeshefi ekzekutiv dhe të tregojë si e ka rregulluar ai çëshjen e blerjes së atyre pajisjeve, si e ka bërë planin e prokurimit, si e ka bërë planin e biznesit, dhe nëse ka arritur më i marrë këto, ku i ka marrë mjetet dhe çfarë ka rrezikuar, sepse po vërehet një paqartësi rreth këtyre mjeteve. Ne si grup parlamentar do ta votojmë për miratim këtë propozim-vendim.

Lidhur me vërejtet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Jehona Lushaku, nënkryetare.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve NPL-së "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

Pika e tetë

Raporti i punës së NPL “Stacioni i Autobusëve” SHA, Prishtinë.

Amir Simnica tha se gjatë vitit 2023 ndërmarrja publike “Stacioni i Autobusëve” në Prishtinë, bazuar në raportin e auditorit të pavarur, ka realizuar gjithsejt 1 milion e 397 mijë e 926 euro të hyra, ku krahasuar me vitin 2022 janë rritur rreth 5%. Të hyrat nga ardhja në ndërmarrje në vitin 2022, vërehet dallimi në të hyra duke pasur parasysh ndryshimet e ndodhura në infrastrukturën funksionale. Stacioni i Autobusëve bazuar në raportin e auditorit të pavarur, ka realizuar afarizëm pozitiv, duke përmbyllur vitin me një fitim prej 131 mijë e 67 euro, krahasuar me vitin 2022 fitimet janë rritur për 6.2%. Sipas raportit zyrtar të inspektorëve të punës, rezulton se ndërmarrja punën e vet e zhvillon duke respektuar në detaje të gjitha dispozitat ligjore të cilat rrjedhin nga Ligji i punës dhe ligjet tjera mbështetëse.

Violeta Salihu tha se nga ajo që kemi shikuar dhe analizuar, ndërmarrja është munduar të paraqesë një raport voluminoz, shpesh me detaje të panevojshme, por pa paraqitje të mjaftueshme të statistikave të viteve të mëparshme, të cilat do të bënin të krahasueshëm më lehtë raportin në fjalë. Vërehet se ka një dyfishim të shpenzimeve operative, të cilat në rreth 46 mijë që ishin në vitin 2022, janë rritur në 83 mijë euro në vitin 2023. Në veçanti vërehet një rritje e shpenzimeve të reprezentacionit të kryeshefit ekzekutiv etj. Po ashtu, vërehen problemet në menaxhimin dhe funksionimin e ndërmarrjes publike “Stacioni i Autobusëve” e që janë konstatuar edhe nga auditori i pavarur, i cili në raportin e tij për vitin 2023 ka dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare që nuk janë përgatitur, në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit etj.

Jeta Rafuna, në emër të Grupit parlamentar falënderoj Amir Simnicën dhe Donjeta Dragushën për punën që kanë bërë si aksionarë në këtë ndërmarrje, e cila dita-ditës ka qenë më profitabile dhe natyrisht që jemi ndarë të zhgënjyer pas komplotit që i’u është bërë për me i shkarkuar këta aksionarë.

Nora Kelmendi tha se disa herë kam kërkuar që të kemi qasje në dokumente publike të ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve”, por asnjëherë nuk kam marrë informatë për Stacionin e Autobusëve, pra janë fshehur të dhënat të cilat i kam kërkuar. Po ashtu, ekziston edhe një dyshim i bazuar për keqpërdorim të parasë publike, respektivisht mëditjeve dhe derivateve për anëtarët e bordit, si dhe faturave gjatë qëndrimit të tyre në Durrës, andaj lidhur me këtë kemi kërkuar që të sillen të gjitha faturat e shpenzimeve të bëra në Shqipëri. Gjithashtu, kemi vërejtur parregullësi rreth publikimit të konkurseve për emërimet në disa pozita të ndryshme në këtë ndërmarrje etj.

Donjeta Dragusha, ish-anëtare e Komisionit të aksionarëve, tha se në Kuvend e kemi sjellë raportin e punës për vitin 2023 dhe se sigurisht që pozitat e reja nuk janë në këtë organogram, sepse është raport i vitit 2023.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngitura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Pika e nëntë

Raporti i punës së NPL "Sport Marketing" për vitin 2023-2024, SHA, në Prishtinë.

Lidhur me Raportin e punës së NPL "Sport Marketing" për vitin 2023-2024, SHA, Pëllumb Bajqinovci, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve, para të pranishmëve bëri elaborimin e këtij raporti për vitin 2023-2024.

Gëzim Sveçla tha se ne kemi kërkuar qasje në dokumente publike në lidhje me transaksionet e ndërmarrjes, dhe aty kemi parë jashtëzakonisht shumë parregullësi, për një pjesë të të cilave ju kemi drejtuar edhe organeve kompetente. Në këtë ndërmarrje kemi një varg shkeljesh si në aspektin financiar, ashtu edhe në fushat e tjera.

Feim Osmani tha se kjo ndërmarrje ka vetëm Pishinën e Gërmisë, e cila i sjell fitime, por mund të konstatojmë se mënyra se si po menaxhohet ajo nuk është në nivelin e duhur, kështu që vonesa prej një muaji të hapjes së pishinës, konsideroi se ka dëmtuar ndërmarrjen. Po ashtu, edhe çmimi ka qenë një pjesë mbi mesataren e pishinave private që ofrojnë sidomos për pjesën e fëmijëve, ku ka shumë pishina në rrethinën e Prishtinës që ofrojnë edhe falas. Pastaj një ndërmarrje e cila ka vetëm një aset, i cili operon maksimalisht 3 muaj, është shumë e vështirë të operojë për 12 muaj dhe konsideroj që menaxhmenti ose politikbërja e Prishtinës duhet të mendojë se si të veprojë tutje më këtë ndërmarrje.

Pika e dhjetë

Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Lidhur me Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Lulëzim Fushtica, drejtor, para të pranishmëve informoi për punën e këtij këshilli.

Feim Osmani tha se do të kishte qenë logjike, sikurse sot të ishte paraqitur kërkesa për miratim të formimit të këtyre këshillave lokalë, andaj do duhet t'u kushtohej rëndësi shumë këshillave lokalë në bashkësi, për arsye se aty merren informata kryesore, sepse banorët ose pjestarët e atij këshilli i dinë problemet e lokalitetit, e cila shumë më lehtë do t'ia përcjellin organit më të lartë, siç është në këtë rast Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Lidhur me sugjerimet e dhëna nga z. Osmani, Lulëzim Fushtica, drejtor dha sqarime të nevojshme.

Pika e njëmbëdhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim rreth moskthimit të përgjigjeve të cilat po u drejtorhen ekzekutivit të Komunës. Lidhur me këtë shtoi se, për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi se çka të parashtrijmë asnjë pyetje, kur nuk janë prezentë as kryetari, as nënkryetari, as drejtorët e drejtorive përkatëse, përveç dy drejtorëve, Kushtrim Mushica dhe Lulëzim Fushtica. Feim Osmani kërkoi që kjo dukuri, mungesa e drejtorëve të drejtorive në mbledhje të mos përsëritet në të ardhmën. Këto dy pikat e fundit të rendit të ditës janë shumë me rëndësi, sidomos për asamblistët, për arsye se është një mundësi shumë e mirë për t'iu drejtuar

drejtorëve, kryetarit, nënkryetarit, më qëllim që të merren përgjigjt të cilat do t'i shkojnë drejtpërdrejt banorit, dhe të mos ketë nevojë me shkresa, e ku mundësia e pritjes mund të jetë së paku një muaj, por mundet edhe mos të merr përgjigje fare.

Në tri dëgjimet publike për buxhet që janë mbajtur, i kam paraqitë të gjitha shqetësimet dhe kërkesat të cilat i kanë pasur banorët, andaj pres që në seancën tjetër, kur të silltet buxheti, të shohim nëse ka pasur vullnet të përfshihen ato kërkesa të banorëve.

Arbnora Berisha tha se pyetjet të cilat i kemi adresuar për drejtorët e drejtorive përkatëse, anjëherë nuk është kthyer asnjë përgjigje. Konkretisht një pyetje që e kam parashtruar, ka qenë edhe ajo për një rast shumë të ndijshëm, i punëtorëve të NPL "Kuzhinës Qendrore", dhe që kanë premtuar se kanë me u kthyer përgjigje, por asnjë përgjigje nuk kam marrë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:15.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe 10 nga 10